



Raport Mujor Qershor 2023

Informacion bazë

Emri i Fondit	Raiffeisen MIKS
Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	Euro
Datë Lancimi	16 Nëntor 2020
Vlera fillestare e kuotës	100
Shuma fillestare minimale	500 Euro
Vlera neto e Aseteve	EUR 2,176,796
Cmimi i kuotës	94.8153
Banka depozitare	Banka e Pare e Investimit, Albania
Banka nëndepozitare	Raiffeisen Bank International, Austria
Kthimi vjetor nga investimi në 30 Qershor 2023	4.73%

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0.00%
Tarifë në dalje	0.00%
Tarifë administrimi vjetore	Deri në 1.30%
Tarifa te tjera te vazhdueshme	Kalkulohen ne fund te vitit kalendarik dhe perfshijne tarifën e paguar ndaj bankes depozitare, auditorit të jashtëm, autoritetit rregullator apo kostot për komunikimin e ndryshimeve në prospekt.
Komisione/tarifa të vazhdueshme	1.59% per vitin 2022 ne 31.12.2022
Komisione të transfertës nga shlyerja e kuotave	Referojuni informacionit ne deget e RBAL
Kosto të transaksioneve	Sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese

Objektivi dhe Politika e investimit

Objektivi i investimit të Fondit është krijimi i të ardhurave të rregullta dhe një rritje e moderuar e kapitalit në një periudhë afatmesme. Asetet e fondit investohen në instrumente financiare që i përkasin tre kategorive kryesore të asetëve: Tituj borxhi, Aksione, Tregu i parasë dhe ekuivalentë cash-i. Në mënyrë që të arrihet qëllimi i investimit, fondi investon deri në 75% të totalit të asetëve në Tituj borxhi, të cilat emetohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, një vend i BE-së apo çdo shtet tjetër i miratuar nga rregullatori vendas, nga institucionet ndërkombëtare

dhe / ose shoqëri tregtare. Për më tepër, për të maksimizuar kthimin total nga investimi, fondi mund të investojë deri në 40% të asetëve në aksione, kryesisht të tregtuar në tregjet e zhvilluara në SH.B.A. dhe Europë. Nëse do të përdoren instrumente financiare derivative, qëllimi do të jetë butja e risqeve dhe arritja e objektivave të politikës së investimit, por faktorë të tillë si likuiditeti i instrumentit tek i cili mbështetet derivativi dhe luhatshmëria e vlerës së tij mund të ndikojnë në performancën e fondit.


Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët

Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë

Përfitimet tipike më të larta




Profili i parashikuar i riskut të Fondit Raiffeisen Miks i përket kategorisë së katërt të treguesit të riskut sintetik dhe përfitimit.

Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk.

Ky tregues ka për qëllim t'ju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Struktura e Portofolit të Investimit




Portofoli i fondit Miks është i ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga investimi dhe diversifikimi në të dy kategoritë e asetëve siç janë obligacionet dhe aksionet. Pjesa e aksioneve (32.6%) është e investuar kryesisht në tregje të zhvilluara: SHBA 19.4%; Zona Euro 8.6%, Britani e Madhe 2.4% e asetëve totale. Niveli i cash dhe i likuiditetit është 4.1%.

Performanca e fondit

Fondi ka shënuar një ecuri pozitive gjatë muajit Qershor. Çmimi i kuotës është rritur me **1.03%** krahasuar me muajin Maj.

Tregu i obligacioneve ishte i luhatshëm dhe yield-et u rritën, pasi deklaratat e vazhdueshme nga Bankat Qendrore dhanë një sinjal të qartë se cikli i politikave shtrënguese nuk ka përfunduar. Megjithatë, yield-et u stabilizuan në fund të muajit. Trendi i inteligjencës artificiale që dominonte tregjet e aksioneve u ndal nga mesi i Qershorit, por aksionet u rimëkëmbën përsëri rreth fundit të muajit, duke e mbyllur gjysmën e parë të vitit me performancë të lartë. Të gjitha të mësipërmet shkaktuan një rivlerësim pozitiv të portofolit të investimeve të fondit Miks, i cili rezultoi me fitim gjatë këtij muaji.

Kthimi neto vjetor i fondit Miks është tashmë pozitiv në nivelin 4.73% më 30 Qershor 2023.



Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Luhatshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur. Investitorët e fondit Raiffeisen Miks dhe te gjithë fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfituar nje

kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond te nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga pandemia globale, sepse ne kete menyre nuk do te riskojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Zhvillimet dhe informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare gjate muajit Qershor

Norma vjetore e inflacionit në SHBA ra në nivelin 4% në Maj 2023, më e ulëta që nga Prilli 2021, dhe pak nën parashikimet e tregut prej 4.1%, e nxitur nga rënia e çmimeve të energjisë. Inflacioni i Eurozonës arriti në 5.5% në Qershor, më i ulët se pritshmëritë e analistëve - por inflacioni bazë, i cili përjashton energjinë dhe ushqimin, mbetet vendosmërisht i lartë, duke u rritur në nivelin 5.4%. Fed e vendosi ciklin e rritjes së normave në pauzë, por parashikimet e saj të reja treguan se norma mesatare e fondeve të Fed u rrit në 5.6% deri në fund të vitit, gjë që është në përputhje me 50 pikë shtrëngime shtesë. Vendimi i BQE-së për të rritur normën e saj bazë me 25 pikë pikë në nivelin 4%, në Qershor, ishte në përputhje me pritshmëritë e tregut dhe të paktën 1 rritje e mëtejshme me 25 pikë pikë pritet në Korrik. BQE konfirmoi gjithashtu se do të ndërpresë riinvestimet e saj në kuadër të Programit të Blerjes së Obligacioneve në Korrik.

Tregu i obligacioneve ishte i paqëndrueshëm dhe yield-et u rritën, pasi deklaratat e vazhdueshme nga Bankat Qendrore sinjalizuan se cikli i politikave shtrënguese nuk ka përfunduar, por ato u stabilizuan deri në fund të muajit. Yield-et e obligacioneve afatgjata ishin relativisht të qëndrueshme në Qershor.

Inversioni i kurbës së yield-eve - ku obligacionet afatshkurtra ofrojnë yield-e më të larta se ato afatgjata, që shihet si një shenjë se investitorët presin një recesion - është thelluar, pasi yield-et për maturimet afatshkurtra janë rritur. Trendi i inteligjencës artificiale që dominonte tregjet e aksioneve u ndal nga mesi i Qershorit, pasi u bë e qartë se cikli i politikave shtrënguese nuk kishte arritur fundin. Megjithatë, aksionet u rimëkëmbën përsëri rreth fundit të muajit, duke e mbyllur gjysmën e parë të vitit me performancë të lartë. Nasdaq është rritur me më shumë se 30% që nga fillimi i vitit, duke përfaqësuar gjysmën e parë më të mirë të vitit që nga viti 1983. Indeksi S&P 500 ka fituar rreth 16%, ndërsa Dow Jones ka një fitim më modest prej 4%. Të dhënat vijnë pas një korrigjimi rritës të papritur të PBB-së së tremujorit të parë që tregoi se ekonomia amerikane është shumë më e fortë sesa mendohej nga Wall Street.

Nga ana tjetër, Shqipëria emetoi një Eurobond të ri me maturim 5-vjeçar për një shumë totale prej 600 milionë euro gjatë muajit Qershor. Obligacioni kishte një normë kuponit prej 5.9% dhe një yield 6.125%, ndërsa kërkesa e investitorëve për emetimin arriti në 1.3 miliardë euro.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dh eforcashitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar t ëkuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrevetë Raiffeisen Invest sha., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank nëShqipëri.